UDHËZIM
Nr. 24, datë 11.9.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 25, DATË 30.11.2007, "PËR PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË VLERËS DOGANORE, BURIMET E INFORMACIONIT DHE AFATET E PUBLIKIMIT TË DOSJES ME TË DHËNA TË DISPONUESHME, SI DHE ZHDOGANIMIN E AUTOMJETEVE DHE PJESËVE TË KËMBIMIT TË TYRE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, "Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe në pikën 81.4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 2.11.2005, me propozimin e komisionit *ad-hoc*, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 25, datë 30.11.2007, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 11.1 zëvendësohet me këtë përmbajtje:

"11.1 Për artikujt e karburanteve, të tilla si: benzinë, gazoil, mazut, solar, vajgur, jet, gazi i lëngshëm (butan, propan), biodiesel (dhe të gjitha nënproduktet) Drejtoria e Vlerës Doganore harton shkresën dhe pas firmosjes nga titullarët e institucionit, ua dërgon degëve doganore dhe njësive të tjera që iu nevojitet ky informacion. Publikimi i këtyre artikujve është çdo ditë pune.".

2. Pika 17 zëvendësohet me këtë përmbajtje:

"17. Në vlerësimin e automjeteve me vit prodhimi para vitit të fundit të publikuar në buletin, vlera nuk mund të llogaritet më pak se:

17.1 Për autoveturat:

a) Deri 1400 cc, jo më pak se 130.000 lekë;
b) Mbi 1400-1900 cc, jo më pak se 200.000 lekë;
c) Mbi 1900-2500 cc, jo më pak se 325.000 lekë;
d) Mbi 2500-3000 cc, jo më pak se 400.000 lekë;
e) Mbi 3000-4500 cc, jo më pak se 500.000 lekë;
f) Mbi 4500 cc, jo më pak se 800.000 lekë.

17.2 Kamioçina, furgonë dhe kamionë:

a) Deri në 1.5 tonë, jo më pak se 400.000 lekë;
b) Nga 1.5 tonë deri në 3.5 tonë, jo më pak se 600.000 lekë;
c) Nga 3.5 tonë deri në 10 tonë, jo më pak se 850.000 lekë;
d) Nga 10 tonë deri në 15 tonë jo më pak se 1.000.000 lekë;
c) Mbi 15 tonë, jo më pak se 1.200.000 lekë;".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani